



NDËRHJRJET E DOMOSDOSHME PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT TË TIK-UT NË KOSOVË

Për: Partitë Politike të Republikës së Kosovës

Nga: Aleanca e Tech Parqeve dhe Inkubatorëve të Kosovës (ATIK)

Data: 15 janar 2025

Subjekti: Propozime për Zhvillimin e Sektorit të TIK-ut në Kosovë

Konteksti dhe Rëndësia

Në epokën e revolucionit digjital, ku teknologjia po drejton ekonominë dhe shoqëritë globale, zhvillimi i fuqishëm i sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) është çelësi për të ndërtuar një ekonomi moderne dhe konkurruese për Kosovën. Sektori i TIK-ut përfaqëson një potencial të jashtëzakonshëm për të nxitur inovacionin, për të përmirësuar konkurrueshmërinë dhe për të krijuar vende të reja pune me vlerë të shtuar. Megjithatë, ky potencial ende nuk është shfrytëzuar plotësisht për shkak të sfidave ligjore, mungesës së mbështetjes financiare dhe mungesës së reformave strukturore.

Kosova ka mundësinë të bëhet një qendër rajonale e inovacionit digjital, por kjo kërkon angazhimin e qartë të politikëbërësve për të krijuar një ambient të favorshëm për zhvillimin e biznesit teknologjik. Politikat e avancuara, infrastruktura moderne dhe investimet e qëndrueshme në burimet njerëzore janë themelet mbi të cilat mund të ndërtohet një ekonomi konkurruese dhe e bazuar në dije.

Aleanca e Tech Parqeve dhe Inkubatorëve të Kosovës (ATIK), që përfaqëson nëntë nga qendrat më të rëndësishme të inovacionit dhe teknologjisë në vend, ka përgatitur këtë dokument për të paraqitur propozime konkrete dhe të qëndrueshme që synojnë të transformojnë sektorin e TIK-ut. Këto propozime, të ndara në shtylla, përfshijnë reforma ligjore të domosdoshme, mbështetje institucionale, nxitje të investimeve private dhe publike, si dhe përmirësim të vazhdueshëm të kapaciteteve njerëzore përmes edukimit dhe trajnimeve të specializuara.

Prandaj, ftojmë të gjitha partitë politike të Kosovës që të përfshijnë këto rekomandime në programet e tyre zgjedhore dhe qeverisëse. Kjo do të jetë një dëshmi e përkushtimit për të ndërtuar një ekonomi moderne, të diversifikuar dhe të qëndrueshme, që reflekton nevojat dhe ambiciet e qytetarëve të Kosovës.

Duke theksuar rëndësinë e një bashkëpunimi të ngushtë ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, ATIK mbetet e përkushtuar për të qenë një partner strategjik në rrugën e zhvillimit të sektorit të TIK-ut. Bashkë mund të ndërtojmë një të ardhme digjitale që krijon mundësi të reja, përmirëson jetën e qytetarëve dhe e pozicionon Kosovën si një lider në rajon.

SHTYLLAT E INTERVENIMIT

1. Legjislacioni:

- Hartimi i Ligjit për E-commerce.
- Hartimi i akteve nënligjore për funksionalizimin e Ligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike (Ligji nr. 08/L – 022).
- Hartimi i Ligjit për krijimin e startup-eve përfshirë themelimin dhe funksionalizimin e Business Angels dhe Venture Capitalists.
- Rishikimi i Ligjit për Sponsorizime në Fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (Ligji nr. 05/L-090).
- Hartimi i Ligjit për Inteligjencë Artificiale.
(Duke përfshirë edhe themelimin e institutit për IA).
- Hartimi i Ligjit për Siguri Digjitale dhe Kibernetike.
(Online Safety).
- Rishikimi i Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212).
(Propozohet rishikimi i pushimit të lehonisë, ndarja e Ligjit në sektorin publik dhe privat, si dhe rregullimi i punës nga shtëpia, sipas praktikave të Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës).
- Hartimi i Politikave dhe Lehtësirave për Nomad Digjital dhe Freelancer-ët.
- Rishikimi i Ligjit për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë (Ligji NR. 06/L-049) dhe Projektligjit për Inovacion dhe Ndërmarrësi.
- Rishikimi dhe plotësimi i Ligjit për Parqet Industriale dhe Teknologjike (Ligji nr.08/L-208).
- Hartimi i Ligjit për Dual VET.

2. Qeveria:

- Themelimi i një Ministrie të dedikuar për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit.
- Krijimi i rolit të CTO-së përbrenda qeverisë.
- Intensifikimi i lobimit për Country Code Top Level Domain (CCTLD) të Kosovës.

- o Riaktivizimi i Këshillit Kombëtar për Inovacion me përfshirjen e ATIK.
- o Organizimi i fushatave informuese për transformimin digjital.

3. Mbështetja Financiare

- o Themelimi i Fondit të Pavarur Zhvillimor për Ndërmarrjet Kosovare të IT-ë.
(Sikurse ne Serbi, Maqedoni të Veriut dhe Mal të Zi. Duke i përfshirë startup-et)
- o Mbështetja e Tech Parqeve, Qendrave të Inovacionit dhe Inkubatorëve.
(Krijimi i Fondit zhvillimor për përkrahjen e Tech Parqeve, Qendrave të Inovacionit dhe Inkubatorëve)

4. Edukimi dhe Zhvillimi i Fuqisë Punëtore

- o Krijimi i një Fondi për Edukim, për studentët e TIK-ut ne formë kreditore.
- o Edukimi gjithëpërfshirës në fushën e IA.

Ftojme të gjitha partitë politike që marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 të përfshijnë këto propozime në programet e tyre. Një angazhim i përbashkët do ta shndërrojë Kosovën në një lider digjital në Ballkan dhe do të krijojë një ekonomi të bazuar në dije.

Me respekt,

Aleanca e Tech Parqeve dhe Inkubatorëve të Kosovës (ATIK)

TECH  PARK

ITP  Innovation & Training Park Prizren

VENTURE ^{UP}

 INNOVATION CENTRE KOSOVO

 PARKU TEKNOLOGJIK

 Makerspace Innovation Center Prizren

 Kosova Innovation Hub

 JIC JAKOVA INNOVATION CENTER.

